

ZHVILLIMI I AFTESIVE PER OJF-të

Planet lokale te veprimit ne mjedis



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
për Evropën Qendrore dhe Lindore

ZHVILLIMI I AFTESIVE PER OJF-të

Planet lokale te veprimit ne mjedis

Përgatitur nga
AGATA MIAZGA dhe **BEATA WISZNIEWSKA**



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
për Evropën Qendrore dhe Lindore

Rreth Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC)

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) është një organizatë jo-partizane, joadvokuese, jofitimprurëse që ka mision të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Qendra përmbush misionin e saj përmes nxitjes së bashkëpunimit mes organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe subjekteve të tjera të fushës së mjedisit, përmes mbështetjes të shkëmbimit të lirë të informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen për mjedisin.

REC është themeluar më 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot, REC mbështetet në Dokumentin themeltar të nënshkruar nga qeveritë e 27 vendeve dhe Komisioni Evropian, dhe në një Marrveshje Ndërkombëtare me Qeverinë e Hungarisë. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyra lokale në secilin nga 15 vendet përfituese të EQL: Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maqedoni, Poloni, Rumani, Sllovaki, Slloveni dhe Jugosllavi.

Donatorët e sotëm janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Shqipërisë, Belgjikës, Bosnjë Hercegovinës, Bullgarisë, Kanadasë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Letonisë, Lituanisë, Hollandës, Polonisë, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-së dhe Serbia dhe mali Zi, si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.

E tërë përmbajtja e këtij publikimi është e mbrojtur me të drejtën e autorit
©2002 Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk lejohet të shitet në asnjë formë ose të riprodhohet për shitje pa lejen paraprake të mbajtësit të së drejtës së autorit.


ISBN: 963 9424 85 4

Përgatitur nga
Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
Ady Endre ut 9-11, 2000 Szentendre, Hungari
Tel: (36-26) 504-000, Faks: (36-26) 311-294
E-mail: info@rec.org, Web site: www.REC.org

Përkthyes: Mimoza Gjika, Redaktimi: Mihallaq Qirjo dhe Alken Myftiu,
Faqsja: Sylvia Magyar dhe Patricia Barna, Ilustrimi: Laszlo Falvy

Të gjitha botimet e REC janë shtypur në letër të ricikluar ose në letër të prodhuar pa përdorimin e klorit ose të substancave me bazë klori.

Material teorik rreth çështjes	5
Pamje e përgjithshme	7
Programi	9
Mjete trainimi	27
Mjeti 1: Analiza SWOT	29
Mjeti 2: Problemet e rastit studimor	30
Mjeti 3: Pasoja dhe efektet	31
Mjeti 4: Shtjellimi i pemës	32
Mjeti 5: Si dhe kush	33
Mjete 6: Analiza e kritereve	34
Shembull i programit të trainimit	35



Material teorik rreth çështjes

Pamje e përgjithshme

Hyrje

Qëllimet

Bazat e trajnimit për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM), kanë si qëllim kryesor dhënien në pamje të përgjithshme të procesit të PLVMsë, për ata që janë të interesuar të zbatojnë projekte të tilla, në komunitetet e tyre. Trajnimi është i vlefshëm, veçanërisht për përfaqësues të atyre komuniteteve, që detyrohen nga legjislacioni lokal të bëjnë zhvillimin e PLVMve.

Përkufizime

PLVM është procesi që përfshin komunitetin lokal dhe shërben për të mbledhur grupe të ndryshme individësh — që ndryshe quhen “grupe të interesuara”. Personat që përbëjnë grupin, bashkëpunojnë me pushtetin lokal gjatë periudhe 12-24 muaj, gjatë së cilës bien dakort mbi prioritetet e përbashkëta të problemeve mjedisore në komunitetet e tyre. Për qëllime të këtij trajnimi, referimi i procesit të PLVMsë bëhet në kontekstin e komunitetit lokal. Gjithësesi, i njëjti proces (ose pak i modifikuar) mund të përdoret suksesshëm edhe në nivele të tjera të qeverisjes (qarku, rajoni, etj).

Grupi i të interesuarve përfshin përfaqësues të institucioneve dhe organizatave kryesore të komunitetit, ekspertë të çështjeve mjedisore, si dhe persona apo individë që zbatojnë projekte të PLVMsë dhe drejtohen për zbatimin e tyre.

Fazat e PLVMsë

PLVMja fillon me përshkrimin e situatës ekzistuese dhe vijon me përcaktimin dhe vlerësimin e problemeve mjedisore. Vlerësimi i plotë i problemeve mjedisore ofron bazën e mjaftueshme për përcaktimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve të shpejta. Faza tjetër e PLVMsë është përcaktimi në terma afatgjatë i qëllimeve që duhet të arrijë komuniteti (p.sh krijimi i vizionit dhe realizimi i qëllimeve strategjike të së ardhmes). Më pas bëhet përshkrimi i hollësishëm i nevojave reale, që duhen për realizimin e qëllimeve strategjike (p.sh përcaktimi i qëllimeve specifike dhe veprimeve konkrete prioritare). Realizimi i fazave të mësipërme vijon me një përshkrim të gjerë të veprimeve të planifikuara, që përfshihen në materialin e PLVMsë. Ky do të shërbejë si dokumenti bazë për përmirësimet mjedisore në komunitet dhe si mjet për të lehtësuar bashkëpunimin mes grupeve të ndryshme të angazhuara në zbatimin e tij.

Ndërthurja me çështjet e tjera

PLVM-të janë të lidhura ngushtë me aktivitete të tjera, si programet për zhvillim të qëndrueshëm, Axiendën Lokale 21 dhe sistemet e menaxhimit mjedisor. Shumë prej këtyre programeve kanë metodologji të ngjashme, pasi përdorin qasjen sipas planifikimit strategjik dhe mbështeten në përfshirjen e gjerë të grupeve të interesuara. Ndryshimet mes tyre rezultojnë kryesisht në synimin përfundimtar ndaj çdo çështjeje ose në strukturën menaxhuese të procesit (p.sh në marrdhëniet mes autoriteteve vendore, grupeve të interesuara dhe njërive lokale koordinuese)

Grupet në nevojë

Ka dy grupe përfituesish të drejtpërdrejtë të projektit, që janë të dallueshëm nga njëri tjetri; përfaqësuesit e autoriteteve të zonës, komunës dhe lokalitetit dhe b) përfaqësuesit e organizatave jo-fitimprurëse që kanë interes të bashkëpunojnë me autoritetet vendore në zhvillimin e PLVMve. Ky modul trajnimi nuk është hartuar që t'iu shërbejë trainerëve të ardhshëm si udhëzues metodologjik. Përkundrazi, ai është hartuar që t'iu shërbejë drejtuesve të komunitetit si udhëzues për zhvillimin e PLVMve. Përdoruesit duhet të kombinojnë njohuritë e marra nga trajnimi me përvojën e tyre duke marrë në konsideratë veçoritë që ndeshen në komunitetet e tyre.

Objektivat e Udhëzuesit

Nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së PLVMsë dëshirojmë të ndihmojmë drejtuesit lokalë në kapërcimin e problemeve dhe sfidave që hasen gjatë procesit të menaxhimit të mjedisit lokal:

- **Bashkëpunimi i dobët mes grupeve të interesuara**
PLVMtë duhet të udhëhiqen nga grupe të ndryshme të interesuarish, në mënyrë që të nxisin kontakte të rregullta mes të gjitha grupeve.
- **Mbështetje e pamjaftueshme nga publiku për veprimet mjedisore**
PLVMtë bazohen në përpjekjet e shumta për të edukuar publikun dhe për të siguruar kontributin e tij në përcaktimin e zgjidhjeve për problemet më të rëndësishme. Kur publiku angazhohet në proces dhe mirë-informohet, atëherë rritet mundësia që ai të marrë pjesë në veprime konkrete.
- **Vizion i copëzuar i menaxhimit mjedisor**
Në shumë komunitete, menaxhimi mjedisor bëhet shpesh mbi baza të veçuara. PLVMtë ofrojnë mjetin për analizën e plotë të problemeve të menaxhimit mjedisor dhe zgjidhjet e tyre. Të gjitha këto janë pjesë e një dokumenti, i cili përmban edhe kuadrin apo skemën menaxhuese të mjedisit në tërësi.
- **Burime të pamjaftueshme për zgjidhjen e problemeve**
PLVM përfshin vlerësimin e problemeve mjedisore dhe zhvillimin e një plani veprimi, në të cilin përcaktohen rrugët për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme mjedisore, dhe nëse është e mundur edhe përfitimet kryesore të investimit.
- **Mungesë koherence me legjislacionin vendas**
PLVMtë ndihmojnë komunitetin të përshtasë kërkesat kombëtare me rregulloret dhe ligjet mjedisore të Bashkimit Evropian. Në vendet ku kërkesa për zbatimin e PLVMve vjen nga ligji kombëtar, atëherë zhvillimi i tyre kontribuon në arritjen e përputhshmërisë mes rregulloreve të BE-së dhe legjislacionit vendas.

Mundësi në përdorimin më efektiv të burimeve ekzistuese të financimit

PLVM mund të përdoret si mjet për zbatimin sistematik të investimeve të mëdha, pa krijuar ngushtime të burimeve organizative dhe financiare në komunitet.

Ngritje kapacitetesh

Trajnimi ju ofron pjesëmarrësve mundësinë që të fitojnë aftësitë dhe njohjet e nevojshme për të zhvilluar PLVM në rajonin, vendin apo komunitetin e tyre.

Kursi në tërësi do t'i shkathtësojë pjesëmarrësit dhe do t'iu zhvillojë aftësinë për të menduar në mënyrë sistematike dhe strategjike. Pjesëmarrësit do të trajnohen mbi mundësinë e organizimit të procesit të PLVMsë, kur ka pjesëmarrje të gjerë në proces të publikut. Vetë procesi përqëndrohet në koordinimin e PLVMsë dhe krijimin e grupit të interesuar.

Përveç të tjerash, pjesëmarrësit do të praktikojnë analizën SWOT, pemën e problemeve, pemën e objektivave dhe analizën e kriterëve, për përzgjedhjen e përparësive.

Në përfundim, ata do të fitojnë njohuri mbi menaxhimin në kushte të vështira të proceseve strategjike të planifikimit (siç janë mungesa e të dhënave, burimet e pamjaftueshme, etj)

Përmbajtja


Trajnimi paraqet parimet kryesore të planifikimit strategjik, i cili shërben si bazë për metodologjinë e PLVM, dhe përdorimin praktik të këtyre metodave në planifikimin mjedisor, kur ka pjesëmarrje të gjerë të publikut në proces.

Dhënia e kursit të trajnimit

Boshti i trajnimit është diagrama e procesit të PLVM (Fig. 1), e cila sikundërse do të diskutohet edhe në trajnim, paraqet fazat e PLVMsë. Gjithashtu, pjesëmarrësit do të njihen me një rast studimor (shih Aneksin 1) të një qyteti të supozuar, i cili do të shërbejë për të shpjeguar secilën fazë të procesit të PLVMsë. Çdo fazë e procesit do të shpjegohet në mënyrë të detajuar, e ndarë në seksione të veçanta. Seksionet e drejtpërdrejta do të vijohen me diskutime, ndërkohë që seksionet komplekse vijohen me ushtrime nga mjetet e trajnimit.

Programi

Në programin e paraqitur është pasur parasysh që trajnimi të zgjasë dy, deri në dy ditë e gjysëm, por shtrirja e tij mund të organizohet edhe ndryshe. Programi vijon me një shpjegim të detajuar të çdo seksioni.



Seksioni 1 — Organizimi i projektit

Zhvillimi i një programi mjedisor mbrojtjeje sipas metodologjisë PLVM, kërkon afërsisht një deri në dy vjet kohë. Proçesi organizohet në 10-12 seminare njëditore, të cilat ndiqen nga grupi i të interesuarve. Për t'u siguruar se proçesi i ndërtuar mbi përpjekjet e grupit të interesuar, po zbatohet në mënyrë efektive dhe sipas afateve të përcaktuara, del nevoja e krijimit të një skeme për koordinimin e projektit. Në varësi të komunitetit, qëllimit të projektit, apo kushteve lokale, mund të ngrihet një njësi koordinuese e përhershme me një ose më shumë persona. Rolin koordinues të projektit, mund ta kryejë një pjesëtar i grupit të interesuar, një konsulent i jashtëm, një përfaqësues i autoriteteve lokale, apo një kombinim i tyre. Detyrimet e njësisë koordinuese përfshijnë:

- Përgatitjen periodike të raporteve mbi ecurinë e proçesit dhe paraqitjen e tyre tek grupi i të interesuarve;
- Menaxhimin e zyrës së PLVM (p.sh përgjigje për kërkesa të ndryshme, menaxhimin e buxhetit të projektit, kontraktimin e ekspertëve, etj);
- Krijimin e një sistemi informues dhe publicitar për PLVM (p.sh faqe interneti, konferenca shtypi, takime publike, sondazhe, ngjarje publike — shih Fig. 2)
- Verifikim dhe sqarimin e dokumentacionit; dhe
- Organizimin e takimeve me grupin e të interesuarve (shih kutinë anash faqes)

Diskutim

Me përfundimin e seancës, pjesëmarrësve mund t'u lihet (rreth 15 minuta) kohe të diskutojnë ide apo mendime rreth mënyrës së zbatimit të projektit në rajonin apo komunitetin e tyre. Kujdes i veçantë duhet treguar për strukturën e njësisë koordinuese, krijimin e sistemit të bashkëpunimit mes njësisë koordinuese, autoriteteve vendore dhe grupit të interesuar, metodat për përfshirjen e publikut dhe njohjen e tij me projektin.

Seksioni 2 — Krijimi i grupit të interesuar

Sa më mirë t'i reflektojnë përbërja e grupit të interesuar interesat e grupeve të ndryshme të komunitetit, aq më të mëdha janë shanset që projekti të jetë i suksesshëm. Për t'u njohur me udhëzimet, që shërbejnë për të ftuar bashkëpunëtorë të tjerë në grupin e të interesuarve, konsulto Figurën 4 të materialit. Kusht thelbësor për anëtarësimin e

PLVM dhe Publiku

Elementi thelbësor i PLVMsë është pjesëmarrja e publikut në proçes. Publiku jo vetëm që duhet të informohet për projektin, por duhet të angazhohet në aktivitete që lidhen me të (si konkurse mjedisore, pikniqe, fushata mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare, etj). Përfshirja e publikut kufizon rrezikun e shmangies së grupit të interesuar nga komuniteti dhe nuk lejon që të humbasë besueshmërinë dhe të shmanget nga vlerat e komunitetit. Ndërkaq, publiku ndihmon për ndërgjegjësimin e komunitetit në çështjet mjedisore.

personave në grupin e të interesuarve mbetet publikimi i hapur informacionit. Qëllimi i saj është që çdokush nga komuniteti të mund të përfshihet në grupin e të interesuarve, apo të marrë pjesë në takimet e para të tij. Kjo mund të realizohet përmes njoftimeve në mediat lokale apo të vendosjes së posterave në vende publike, etj. Përveç kësaj, në takimet e para është mirë të dërgohen ftesa individuale për njerëz apo institucione të veçantë.

Personat e interesuar në PLVMnë mblidhen në mbledhjen e parë, gjatë së cilës bëhet paraqitja e projektit dhe krijohet grupi i të interesuarve. Mbledhja e parë mund të vijojë menjëherë me takimin e parë për planin e aktiviteteve. Takimi mund të trajtojë tema që lidhen me vlerësimin paraprak të potencialit dhe kufizimeve të komunitetit (shih Seksionin 3). Pavarësisht nga kjo takimi mund të trajtojë edhe çështje të tjera, përveç atyre të sipërpërmendura (p.sh shih rregullat e grupit, planin e punës)

Me qëllim që takimi i parë të jetë më interesant dhe tërheqës për publikun e gjerë, është mirë t'i kushtohet kujdes organizimit të një ngjarjeje sociale modeste (si p.sh festival për ushqimin organik,

konkurs për vizatimin e stemës së programit, teatër apo shfaqje shkolle për problemet mjedisore)

Diskutim

Pas seancës paraqitëse mund të zhvillohet një diskutim 15 minutësh, i cili duhet të përqëndrohet në pikat si më poshtë:

- Përbërja e grupit të interesuar
- Shpërndarja e informacionit për takimin e parë dhe e ftesave për përfaqësuesit e përzgjedhur të grupit të interesuar dhe
- Programi i takimit, ku të përfshihen miqtë e ftuar, folësit dhe të dhëna për organizimin e aktivitetit.

Seksioni 3 — Vlerësim paraprak mbi kapacitetin dhe kufizimet e komunitetit

Një ndër metodat për vlerësimin e kapacitetit dhe kufizimeve të komunitetit është analiza SWOT. Takimi për analizën SWOT, mund t'i shërbejë grupit të interesuar si “nxehtë”, përpara se ai të kalojë tek fazat e tjera më të vështira të procesit të PLVMsë. Ai i shërben anëtarëve të grupit për të gjetur veten brenda komunitetit dhe për tu integruar në grupime të rastësishme individësh. Rezultatet e takimit përbëjnë bazën e mjaftueshme për raportin e gjendjes mjedisore (shih seksionin 4).

Zakonisht, si faktorë të brendshëm të komunitetit, konsiderohen “Anët e forta” dhe “Anët e dobta”, ndërkohë që “Mundësitë” dhe “Rreziqet” konsiderohen faktorë të jashtëm. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi i faktorëve të brendshëm (Anët e forta dhe të dobëta) të bëhet paralelisht me vlerësimin e faktorëve të jashtëm, që mund të ndikojnë në komunitet. P.sh, ndërgjegjësimi i qytetarëve për mjedisin mund të konsiderohet si forcë e brendshme, ndërkohë që mundësia për grante apo hua nga institucionet donatore që operojnë në fushën e mjedisit, është faktor i jashtëm. Nga ana tjetër, niveli i ulët apo shkalla e dobët e ndërgjegjësimit të banorëve të komunitetit, mund të konsiderohet si dobësi e brendshme dhe mungesa e financimeve vendase për programe

Organizimi i takimit të grupit të interesuar

Grupi i të interesuarve duhet të miratojë programin e takimeve të tij që në fillim të procesit dhe duhet t'i përmbahet sa më shumë parashikimeve të programit. Dërgimi i ftesave individuale për anëtarët e grupit të interesuar bëhet përpara çdo takimi. Takimet duhet të kenë qëllime të qarta për të mos krijuar tek pjesëmarrësit ndjesinë se kjo punë është humbje kohe. Atyre iu duhet krijuar mundësia për të pushuar ndërmjet takimeve. Ndaj rekomandohet që pas takimeve të grupit të interesuar të organizohen aktivitetet me karakter shoqëror.

FIGURA 2

Grupimet që duhen patur parasysh për krijimin e grupit të interesuar

- Autoritetet e pushtetit vendor (këshillat bashkiakë, zyrtarë anëtarë të kryesive të komunitetit dhe të administratës vendore, p.sh organet e specializuara, si inspektoriatet apo agjencitë për mbrojtjen mjedisore)
- Organizatat Jo-Fitimprurëse (p.sh organizatat lokale, rajonale dhe kombëtare shoqatat e akademikëve, organizatat rinore, të fermerëve, klubet shoqërore);
- Shkollat, universitetet dhe institucione të tjera edukative
- Spitalet dhe institucione të tjera të shëndetit publik, përfshi edhe shërbimet veterinarë
- Organizimet lokale të biznesit (p.sh industrinë, dhomat e tregtisë, klubet e biznesit,

Analiza SWOT

- Anët e forta,
- Anët e dobta,
- Mundësitë,
- Rreziqet

lokale konsiderohet rrezik i jashtëm. Figura 4 jep një model të thjeshtë të analizës SWOT, bazuar në PLVMnë e rajonit të Belogradchikut në Bullgari.

Analiza SWOT duhet të mbulojë, të paktën disa prej fushave të mëposhtme:

- Kushtet natyrore lokale (terrenin natyror lokal, shumëllojshmërinë biologjike, burimet natyrore, turizmin, pasuritë tokësore, etj).
- Burimet njerëzore (ekzistencën e tregut të kualifikuar dhe pak të kushtueshëm të punës, sipërmarrjen individuale, përfshirjen e qytetarëve në çështjet komunitare, forcimin e lidhjeve shoqërore dhe kulturore, etj).
- Infrastrukturën teknike (gjendjen e rrugëve, sistemin e grumbullimit të ujrave të zeza dhe trajtimin e tyre, furnizimin me ujë, ngrohjen e shtëpive gjatë dimrit, etj).

FIGURA 3

Shembull i analiza SWOT për rajonin e Belogradchik në Bullgari

Faktorët e brendshëm

ANET E FORTA

- Veçanti të pejsazhit natyror, me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Mjedis i pyllëzuar pa ndotje dhe dëmtime.
- Angazhim nga drejtuesit lokalë për të promovuar turizmin, bazuar në cilësinë e burimeve natyrore lokale.
- Mungesa e industrive ndotëse në zonë.
- Prania e muzeut natyror me personel të kualifikuar.

ANET E DOBTA

- Shterrimi i fondeve në komunitet
- Shkarkime nga tubacionet e grumbullimit të ujrave të zeza në rrethinat e qytetit
- Burime të pamjaftueshme të ujit të pijshëm
- Mbajtja e kafshëve në vende të papërshtatshme
- Pajisje të amortizuara dhe të pafavorshme të grumbullimit të mbetjeve
- Vendet ekzistuese për grumbullimin e mbetjeve nuk plotësojnë kërkesat e legjislacionit

Faktorët e jashtëm

MUNDËSITË

- Politika kombëtare të favorshme për zhvillimin e turizmit
- Komuniteti është pjesë e rajonit veri-perëndimor i cili është piketuar për zhvillimin e një programi të veçantë kombëtar për ndihmë ekonomike
- Përpunimi i bimëve mjekësore
- Projektet ndërkufitare janë prioritet i donatorëve

RREZIQET

- Varësi e vazhduar ndaj pushtetit qendror
- Marxhinalizim i vazhduar i minoritetit të romëve
- Fokusimi i vëmendjes së donatorëve në bashkitë më të mëdha të vendit

- Potencialin ekonomik (zhvillimin e degëve të veçanta të industrisë si psh përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, tregëti, tendencat e zhvillimit në të ardhmen, fluksin e investimeve, nivelin ekonomik të popullsisë, etj)

Seksioni 4 — Raporti i gjendjes mjedisore

Vlerësimi i dhënë në seksionin e mëparshëm mbi kapacitetin dhe kufizimet e komunitetit, është pikënisje e mirë për vlerësimin e mjedisit në komunitetin tuaj. Rezultatet e vlerësimit paraqiten në raportin e gjendjes mjedisore. Për analizimin e gjendjes së mjedisit është e rëndësishme të merren parasysh jo vetëm çështjet që lidhen me mjedisin natyror, por edhe ato që lidhen me cilësinë e jetës së banorëve dhe të proceseve shoqërore dhe ekonomike që zhvillohen në komunitet.

Raporti i gjendjes mjedisore duhet të përfshijë:

- Përcaktimin e kufijve territoriale që përfshin PLVM
- Inventarin e burimeve natyrore dhe objekteve ndërtuar nga njeriu duke përfshirë edhe zonat më problematike
- Vlerësimin e mjeteve publike, bashkë me kapacitetin dhe efektivitetin e infrastrukturës (psh pajisjet për trajtimin e ujrave të zeza)
- Lidhjet midis çështjeve me karakter ekonomik, shoqëror dhe mjedisor
- Analizën e kuadrit dhe detyrimeve ligjore

Analizimi i mirë e gjendjes ekzistuese nga komuniteti vendor ndihmon në përcaktimin e drejtë të problemeve mjedisore dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme.

Diskutim

Pas paraqitjes mund të bëhet një diskutim rreth 15 minuta, lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen e raportit dhe modifikimet e mundshme të tij (nga kush dhe mbi çfarë bazash duhet parapërgatitur raporti).

Seksioni 5

Në takimin e rradhës grupi i të interesuarve duhet të shqyrtojë raportin e gjendjes mjedisore, njohjen që ka grupi rreth komunitetit dhe rezultateve të vëzhgimit për rolin e qytetarëve në përcaktimin e problemeve mjedisore.


Është e rëndësishme që të trajtohen çështjet, si më poshtë:

- Cilësia dhe komponentët e mjedisit natyror lokal (p.sh ajri, toka, nëntoka, ujrut sipërfaqësore, niveli i zhurmave, etj).
- Ndotja e burimeve dhe efekti i tyre në mjedisin natyror (p.sh zonat industriale, minierat dhe ndërmarrjet e përpunimit të lëndës së parë, ndërmarrjet e përpunimit të mbeturinave komunale, si dhe mungesën e vendeve për depozitimet e mbetjeve të ngurta dhe depozitimet e kundraligjshme)
- Mundësia e banorëve për të shfrytëzuar burimet mjedisore me cilësi të përshtatshme (p.sh uji i pijshëm, mundësitë për pushim dhe argëtim, etj).
- Përdorimi dhe menaxhimi racional i burimeve natyrore duke përfshirë përdorimin e tokës, shfrytëzimin e tejskajshëm të zonave me vlerë natyrore dhe humbjen e tyre
- Gjendja shëndetësore e popullsisë lokale (p.sh përqindja e vdekjeve tek të porsalindurit, sëmundjet profesionale, dhe jetëgjatësia mesatare e banorëve)

Lista e problemeve mjedisore nuk duhet të përfshijë vetëm shqetësimet e së sotmes, por edhe problemet e së ardhmes. P.sh burimet e ujit të pijshëm në një bashki, sot ende të pandotura, mund të ndoten në mënyrë aksidentale në të ardhmen si rezultat i shkarkimit të ndotësve nga pikat e afërta të karburanteve apo të një fushe përpunimi të mbeturinave. Probleme të tilla duhet të përfshihen në listën e shqetësimeve tuaja mjedisore. Që të ndihmohet përcaktimin e rrezeve të mundshme, bëni pyetjen “Çfarë ndodh nëse ...”: "... ndotja vjen nga vendet e grumbullimit të mbetjeve?”, “Çfarë efektesh do të ketë mbi shëndetin e banorëve dhe mjedisin?”.


FIGURA 4

Analiza në trajtë peme e problemit



Seksioni 6 — Vlerësimi i problemit

Për vlerësimin e problemeve mjedisore përdoret një shumëllojshmëri metodash. Zgjedhja e tyre nga komuniteti mund të bëhet në varësi të madhësisë së tij, kushteve lokale, apo parapëlqimit për çështje të caktuara. Njëra prej metodave që përdoret më shpesh në komunitetet e mëdha ose rajont e gjëra me kompleksitet problemesh mjedisore, është metoda krahasuese e vlerësimit të riskut. Një metodë tjetër që mund të përdoret për rastet më të thjeshta në komunitete mesatare, është analiza në trajtë peme e problemit. Metoda e mësipërme është zgjedhur për t'u paraqitur në manualin e këtij trajnimi. Analiza në trajtë peme e problemit përfshin përcaktimin e problemeve kryesore



Qëllimet strategjike duhet të:

- përcaktojnë situatën e dëshiruar dhe të udhëheqin grupet e angazhuara, në përpjekjet e tyre për zbatimin e PLVMsë.
- drejtojnë zhvillimin e strategjive të hollësishme për zbatimin e secilit objektiv
- reflektojnë parashikimin e grupit të interesuar dhe banorëve të tjerë
- adresojnë fushat e problemit, që janë përcaktuar në fazat e mëparshme të PLVMsë, dhe shkojnë përtej zgjidhjeve të thjeshta për probleme të veçanta
- jenë në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, por vëmendja të mbetet e përqëndruar në fushat lokale të projektit (zbatimi i strategjive duhet të mbetet nën autoritetin e grupit për të cilin është hartuar projekti)

dhe krijimin e lidhjeve shkak-pasojë mes këtyre problemeve. Qëllimi kryesor i analizës është identifikimi dhe adresimi i vazhdueshëm i shkaqeve bazë (dhe jo i simptomave të problemit), në punën për hartimin e projektit.

Për të shpjeguar filozofinë që qëndron në bazë të kësaj metode mund të përdorim një analogji nga fusha e shëndetësisë: Nëse keni një dhimbje kronike dhe merrni një qetësues për ta trajtuar, atëherë keni trajtuar simptomën dhe jo shkakun e problemit. Qetësuesi fsheh treguesin (dhimbjen) e shkaktarit të problemit shëndetësor, i cili mund të keqësohet akoma më shumë nëse nuk trajtohet. Problemi përsëritet, kur efekti i qetësuesit bie ose zbehet. Përveç kësaj, trupi fillon të bëhet gradualisht rezistent ndaj qetësuesit. Me kalimin e kohës, trupi kërkon doza më të mëdha qetësuesish për të lehtësuar të njëjtën dhimbje. Projektet që adresojnë simptomat e problemit dhe jo shkaqet e fshehta të tij, nuk mund të sjellin përfitime të vazhdueshme.

Analiza e qartë dhe e plotë e problemit është themel i sigurtë për të vendosur disa objektiva të qëndrueshme për fazat e mëtejshme të procesit PLVM. Fig. 5 jep një shembull të analizimit në trajtë peme të problemit.

Do t'ju duhet të kujtoni se analiza në trajtë peme e problemit, nuk është një metodë shkencore. Ajo bazohet në arritjen e konsensusit të përgjithshëm, duke pasur parasysh se njerëzit mund të gabojnë edhe kolektivisht. Këshillohet të bëhet kontrolli i dyfishtë i pemës së problemeve edhe nga burime të tjera informacioni, që merren me trajtimin e problemeve mjedisore.

Seksioni 7 — Përcaktimi i qëllimeve strategjike dhe objektivave specifikë

Ky seksion mund të fillojë me një ushtrim, për të krijuar përfytyrimin mbi vizionin e komunitetit. Organizimi i ushtrimit mund të jetë në formën e një seksioni gjatë së cilit pjesëmarrësve u kërkohet të japin ide rreth vizionit të përbashkët për komunitetin e tyre në 20-30 viteve të ardhshme. Vizioni nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore. Përkundrazi, imazhi i dëshiruar i së ardhmes duhet të jetë sa më i plotë që të jetë e mundur. Për më tepër, ai duhet të përmbajë tregues të mundësive të ofruara dhe rreziqeve që mund të shfaqen përgjatë realizimit të procesit. Përshkrimi i vizionit të dëshiruar, siç paraqitet në dokumentin e PLVMsë duhet të zërë një deri në dy faqe. Gjithësesi, përmbledhja e tij mund të "tkurret" deri në një fjali apo paragraf, si në rastin e PLVMsë në Poloni: "Starogard Dganski — një qytet miqësor për njerëzit dhe mjedisin"

Vizioni duhet të japë drejtimet e përcaktimit të qëllimeve strategjike, zbatimi i të cilave është i nevojshëm për kthimin e vizionit në realitet. Udhëzimet për formulimin e qëllimeve strategjike mund t'i gjeni në tabelën anash faqes. Shembuj të qëllimeve strategjike mund të jenë p.sh: "Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor të banorëve të komunitetit", ose një tjetër më i matshëm "Zvogëlimi i ndotjeve atmosferike brenda nivelit të normave kombëtare". Hapi që vjen pas përcaktimit të qëllimeve strategjike është zhvillimi i objektivave specifikë, të cilat vendosin piketat për matjen e progresit drejt arritjes së vizionit dhe përfytyrimit të pritshëm e të dëshiruar.

Objektivat duhet të:

- përqëndrohen më tepër në mënyrat për arritjen qëllimit strategjik, sesa në parashikimet e grupit të interesuar.
- formulohen në mënyrë të tillë që të eliminojnë sa më shumë të jetë e mundur elementet e pasigurisë në procesin e zbatimit të PLVMsë; dhe

- japin siguri se zbatimi i tyre do të eliminojë, ose të paktën do të minimizojë problemet e përcaktuara në fazat e para të procesit.

Në shumë materiale metodologjike, karakteristikat e objektivave përmbledhen në fjalën “SMART” e formuar nga gërmat e para të disa fjalëve. (Specific — specifik, Measurable — i matshëm, Achievable — i arritshëm, Relevant — i rëndësishëm, Timed — i përcaktuar në kohë). Përshkrimi i mësipërm përdoret për të verifikuar në mënyrë të dyfishtë, nëse objektivat specifike të PLVMsë plotësojnë kërkesat bazë të metodologjisë. Është e rëndësishme që shprehja e qëllimeve dhe objektivave të jetë sa më e qartë për të mos krijuar vështirësi në interpretimin e tyre. Kjo ndihmon që vëmendja të përqëndrohet më tepër në zbatimin e objektivave, sesa në interpretimin e tyre.

Disa shembuj të objektivave specifike janë p.sh : "Gjithë ujrat e zeza duhet të grumbullohen në kanalizime, deri në 2010", ose "Konsumi i ujit duhet kufizuar në masën 5 % deri më 2005". Siç paraqitet qartë nga shembulli, objektivat duhet t'u paraprijnë periudhave kohore nga 5 deri në 10 vjet, në varësi të kohës që parashikon procesi i PLVMsë. Pasi objektivat arrihen, atëherë ato modifikohen ose hiqen nga plani i veprimit.

Analiza në trajtë peme e objektivave është një metodë e mirë që përdoret për përcaktimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike (shih figurën 6). Pema e objektivave është, në thelb, vazhdimi i pemës së problemeve, e cila ndjek rrënjët e problemit dhe përpiqet t'i "kurojë" ato duke çuar deri në zgjidhjen e vetë problemit. Formulimi i objektivave fillon me shndërrimin e problemeve, shkaqeve dhe efekteve në fjali pozitive, duke ngritur një pemë “pozitive”. Zhvillimi i mirë i diagramës së pemës së objektivave përbën fillesat për formulimin e veprimeve konkrete. Nëse dëshirojmë të kemi një proces të plotë PLVMje, atëherë programi nuk duhet të kufizohet vetëm në çështjet që janë analizuar në pemën e problemeve dhe objektivave.

Seksioni 8 — Përcaktimi i veprimeve

Pas përcaktimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike, grupi i interesuar duhet të zhvillojë planin e veprimit. Kjo fazë ka të bëjë me përcaktimin e veprimeve të nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike. Lista në tabelën anash faqes jep llojet e veprimeve që mund të jenë pjesë e PLVMsë.

Secili prej veprimeve duhet pasqyruar hollësisht në dokumentin e PLVMsë. Përshkrimi duhet të përfshijë të paktën elementët e mëposhtëm:

- lidhjen e veprimit të përcaktuar me qëllimin strategjik dhe objektivat specifike,
- treguesit e suksesit që tregojnë nëse qëllimet strategjike dhe objektivat përkatës janë arritur,
- ndarjen sipas fazave të nevojshme për zbatimin e veprimeve
- organizatat dhe individët zbatues, të cilët janë përgjegjës për ecurinë e çdo veprimi
- koston për fazë
- afatet kohore
- burimet e mundshme të financimit


Për përcaktimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave përkatës ka disa rregulla që duhen respektuar, përpara se të kalohet tek veprimet dhe hapat për zbatimin e tyre. Kini parasysh që lista e

Veprimet që rekomandohen në procesin e PLVMsë

- Parandalimi i ndotjeve dhe marrja e masave teknologjike (p.sh instalimi i përpunuesve biologjikë të ujrave të zeza në sistemin ekzistues, zgjerimi i sistemit të kanalizimeve)
- Masat informuese dhe edukative (p.sh organizimi i fushatave senzibilizuese, krijimi i qendrës së informimit, publikimi i udhëzuesit të gjelbër për konsumatorët)
- Masat ekonomike (p.sh paraqitja e një sistemi tarifimi bazuar në konsumin e ujit në shtëpi nëpërmjet matësive, tarifa më të ulta kur zbatohet ndarja e mbeturinave)
- Masat ligjore (p.sh zhvillimi i rregulloreve bashkiake për përdorimin e tokës për të mbrojtur tokat bujqësore dhe që nxisin futjen në përdorim të zonave që kanë nevojë për pastrime dhe përmirësime ose futje nën kulturë)
- Masat organizative (p.sh krijimi i një departamenti të veçantë mjedisor brenda strukturës së autoriteteve vendore, punësimi i personelit shtesë në departamentin e mjedisit).
- Masat detyruese (p.sh gjokat për rastet e shkeljeve, mbyllja e bizneseve që veprojnë arbitrarisht ndaj ligjeve dhe rregulloreve).


FIGURA 5

Analiza në trajtë peme e objektivave



veprimeve për arritjen e një objekti të veçantë duhet të jetë sa më e plotë. Kjo do të thotë që përcaktimi i veprimeve duhet bërë në mënyrë të tillë që përfundimi i suksesshëm i tyre të shënojë realizimin e objektivit përkatës. Në mënyrë të ngjashme edhe kur planifikojmë hapat për zbatimin e një veprimi, duhet të kemi gjithnjë parasysh nëse ekzistojnë kushtet e nevojshme për realizimin e suksesshëm të tij.

Përcaktimi dhe përshkrimi i veprimeve është njëra prej vështirësive më të mëdha me të cilat ndeshet grupi i të interesuarve. Gjatë kësaj faze të procesit është gjithmonë e nevojshme të ftohen ekspertë të tjerë, meqënëse anëtarët e grupit të interesuar mund të mos kenë njohuri të mjaftueshme për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve që duhen zbatuar. Kjo fazë e PLVMsë kërkon një bashkëpunim të ngushtë mes grupit të interesuar,



autoriteteve vendore dhe grupeve të tjera që mund të jenë përgjegjëse për zbatimin e veprimeve në të ardhmen. Në disa raste mund të jetë me interes që autoritetet vendore të bashkëpunojnë me komunitete të tjera që kanë punuar ose punojnë në çështje të ngjashme. Figura 8 jep një shembull të planit të veprimit për infrastrukturën e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm sipas standarteve të BE-së.

Seksioni 9 — Përcaktimi i prioriteteve për veprim

Duke pasur parasysh që PLVMja është një dokument i plotë dhe i zgjeruar, rekomandohet të propozohen veprimet / masat përkatëse. Për këtë fillimisht duhet rënë

FIGURA 6

Tabela e prioriteteve të PLVMsë për Bashkinë e Mariupolit

RENDITJA E KRITEREVE	PRIORITETET		
	I lartë (3 pikë)	I mesëm (2 pikë)	I ulët (1 pikë)
Kosto (në USD)	Der në 10,000	10,000-1,000,000	Mbi 1,000,000
Koha (në vite)	Deri 1	2-3	Mbi 3
Rëndësia e problemit (1 është më i larti)	1-4	5-7	8-9
Mobilizimi i publikut (nr. i njerëzve)	> 10,000	2,000-10,000	< 2,000
Efektet e dukshme (% e qytetarëve)	> 70%	10-70%	< 10%

Bazuar në shumën e pikëve, veprimet e propozuara mund të ndahen në tre grupe, p.sh
 Grupi I 13-15 pikë
 Grupi II 10-12 pikë
 Grupi III 5-9 pikë

dakort, se cilat do jenë për kriteret, sipas të cilave do të bëhet renditja e veprimeve më prioritare apo më pak prioritare.

Në përgjithësi, kriteret duhet të pasqyrojnë jo vetëm sistemin e vlerave dhe shqetësimeve të komunitetit të paraqitura nga grupi i interesuar, por edhe mundësitë teknike, ligjore dhe ekonomike për zbatimin e planeve dhe veprimeve të caktuara. Këto kriteret janë shumë të rëndësishme në zbatimin e mëvonshëm të çdo veprimi të identifikuar.

Është mirë që merren në konsideratë kriteret e mëposhtëme:

- rreziqet ndaj shëndetit njerëzor, cilësisë së jetës dhe mjedisit (duke përfshirë

FIGURA 7

Shembull i PLVMsë për qytetin Mariupoli, Ukrainë

Qëllimi Strategjik	Objektivat Specifike	Treguesit	Veprimet	Hapat
1 Infrastruktura e ujit në përputhje me legjislacionin e BEsë	1.1 Zgjerimi i sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit të ujrave të zeza	100% e popullsisë e lidhur në rrjetet përjashtohen rastet e pajustificuara	1.1.1 Shtrirja e sistemit të grumbullimit	A. Përgatit dokumentacionin teknik të ujrave të zeza
				B. Përgatit analizën ekonomike dhe financiare
				C. Ndërto gradualisht rrjetin e ujrave të zeza

opinionet e shprehura në sondazhet publike)

- përputhja me rregulloret, standartet dhe prioritetet e politikave lokale, rajonale dhe kombëtare
- kostot e zbatimit dhe administrimit, efektiviteti i kostove
- Koha e zbatimit
- Kohëzgjatja e efekteve
- Mundësitë e financimit
- Mundësitë teknike
- Shpejtësia dhe lehtësia e zbatimit
- Parapëlqimi dhe mbështetja e publikut
- Numri i njerëzve që përfitojnë; dhe
- Ndikimi në zhvillimin ekonomik

Figura 7 paraqet kriteret që janë përdorur për të përcaktuar aktivitetet prioritare për PLVMnë e Mariupolit në Ukrainë.

Skema e përmbajtjes së PLVMsë

- Letra hyrëse nga kryetari i bashkisë ose këshillit bashkiak
- Përmbledhja e përgjithshme
- Hyrja të shkurtër të PLVMsë (të shpjegojë se çfarë është dhe si duhet zhvilluar)
- Vlerësimi e problemeve mjedisore
- Plani i veprimit (mund të përmblihet në formën e tabelës për çdo objektiv)
- Shtojcat (mund të përfshijnë raportin e gjendjes mjedisore, harta, tabela, foto, analiza shtesë, etj)

Seksioni 10 — Puna për shkrimin e dokumentit të PLVMsë

Ekzistojnë disa rrugë për të strukturuar një dokument PLVMje. Një nga strukturat e mundshme është dhënë edhe në tabelën anash faqes. Është e kuptueshme se dokumenti përfundimtar i PLVMsë duhet të ketë karakteristikat e një projekti. Ai duhet të jetë konçiz dhe i orientuar drejt thelbit të problemit. Kuptohet se disa prej materialeve të përgatitura nga grupi i interesuar duhen lënë jashtë strukturës dhe materialit të PLVMsë. Ndërkohë që do të jetë mirë që krahas përgatitjes së dokumentit të PLVMsë të përgatitet edhe një raport përfundimtar i ecurisë së këtij procesi, i cili duhet të përfshijë gjithë dokumentacionin dhe materialet më të rëndësishme. Për më tepër, ky raport mund të shërbejë si burim reference për të gjitha palët e interesuara dhe do të sigurojë

Autoriteti Përgjegjës	Afati i fundit kohor	Kostot	Burimet e financimit
Këshilli bashkiak në bashkëpunim me administratorët e rrjetit të furnizimit me ujë	2004	EUR 2,000	■ Buxheti i bashkisë
Këshilli bashkiak në bashkëpunim me administratorët e rrjetit të furnizimit me ujë	2004	EUR 3,000	■ Buxheti i bashkisë
Administratorët e rrjetit të furnizimit me ujë	2010	Sipas analizës financiare	■ Buxheti i bashkisë ■ Financim rajonal për mjedisin

Për më tepër informacion mbi planifikimin dhe zbatimin e procesit të PLVMsë, në Evropën Qëndrore dhe Lindore, mund të vizitoni faqen e REC-ut në internet në adresën: <www.rec.org/REC/Programs/LocalInitiatives/PLVM/>. Faqja përmban informacion bazë për procesin e PLVMsë, rekomandime rreth kërkesave kombëtare për PLVMtë në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore, si dhe shembuj projektesh ku përfshihen përmbledhje dhe variante të plota të dokumenteve të PLVMsë. Përveç këtyre materialeve, në këtë faqe do të gjeni edhe një listë të materialeve referuese (përfshi materialet e trajnimit), adresa interneti të organizatave apo agjencive, të përfshira në aktivitete për PLVMtë.

transparencë për të gjithë procesin duke e bërë të vlefshme punën e grupit të interesuar.

Diskutim

Pas paraqitjes, rekomandohet një diskutim rreth 15 minuta rreth qëllimit dhe përmbajtjes së dokumentit të PLVMsë, si për aspektet praktike të përgatitjes së tij (p.sh, çfarë duhet bërë dhe kush duhet ta bëjë, me kë duhet konsultuar, etj).

Seksioni 11 — Zbatimi dhe monitorimi

Versioni paraprak i PLVMsë duhet diskutuar dhe aprovuar në seksionin përfundimtar i grupit të interesuar, për t'u dërguar më pas tek autoritetet vendore për fillimin e zbatimit. Këshillohet që dorëzimi i PLVMsë të bëhet në mënyrë sa më ceremoniale dhe publike. Dorëzimi i tij mund të jetë pjesë e një sesioni të veçantë në takim të këshillit vendor dhe mund të shoqërohet me një konferencë shtypi dhënë prej autoriteteve të larta të tij (të këshillit). Në këtë aktivitet ftohen autoritete vendore dhe zonale.

Padyshim që mund të ndodhë që autoritetet vendore të mos jenë në të njëjtën mendje me rekomandimet e grupit të interesuar. Megjithatë kur projekti është i përgatitur mirë dhe kur grupi i interesuar ka punuar në bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me përfaqësuesit e autoriteteve vendore për përgatitjen e tij, atëherë përgjithësisht këshilli vendor e miraton PLVMnë.

Dokumenti ka vlerë për autoritetet vendore, pasi përfaqëson mendimet dhe opinionet e komunitetit, rëndësinë dhe specifikën e problemeve, si dhe zgjidhjet e mundshme. Detyra e fundit afat-gjatë e grupit të interesuar është të monitorojë procesin e zbatimit të PLVMsë, ta rinovojë këtë të fundit duke bërë shtesa apo përshtatje të tij. Pas zgjedhjes së një strategjie të caktuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, përgatitet një plan sistematik për zbatimin e planit të aktiviteteve, me qëllim që të sigurohet përmirësimi pozitiv i mjedisit në përputhje me objektivat e vëna. Monitorimi i vazhdueshëm i programit është një faktor që ndihmon të shihet efektiviteti dhe zbatimi në kohë i detyrave të ngarkuara nga personat përgjegjës për to. Sikundërse ka ndodhur shpesh, lënia jashtë hartimit dhe miratimit të PLVMsë e mekanizmave inspektues, mund të sjellë përvojën jo të mirë kur edhe planet më të përkryer përfundojnë të harruar dhe mbuluar nga pluhuri nëpër sirtarë. Veprimet për të cilat është arritur marrëveshja nuk harrohen vetëm nëse ka një program monitorimi sistematik, i cili është pjesë integrale e planit për zbatimin e aktiviteteve. Zbatimi efektiv kërkon verifikim.

Diskutim

Pas paraqitjes rekomandohet një diskutim rreth 15 minuta mbi organizimin e hapave të mëtejshëm (p.sh roli që do ketë grupi i të interesuarve në të ardhmen, organizimi i punës për zbatimin e PLVMsë, etj)

Seksioni 12

Organizimi i këtij seksioni bëhet në formën e një diskutimi të hapur, përmbledhës dhe përfundues për kursin e trajnimit. Disa nga temat që rekomandohen mund të jenë:

- mundësia e aplikimit të kësaj metode në komunitet
- interesi i pjesëmarrësve për të zbatuar PLVMnë
- PLVMja në raport me mënyrat e tjera të planifikimit strategjik (anët “pro” dhe anët “kundra”)
- vlerësimi individual për trajnimin

FIGURA 8

Rast Studimor — Qyteti PLVM

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Qyteti PLVM (me popullsi 50,000) ndodhet në rajonin me rëndësi ndërkombëtare të Korridorit Lindje. Hekurudha që kalon përgjatë qytetit, shërben edhe për transportin ndërkombëtar.

Qyteti ndodhet në luginën e lumit “PLVMi”, i cili përshkon një zonë kodrinore (kryesisht me përbërje argjilore, rëre dhe zhavorore). Industria shkrirëse filloi të zhvillohej disa dhjetra vjet me parë, si rezultat i depozitimeve gjeologjike të meneralit në rajon. Depozitimet minerare ekzistuese, nuk kënaqin më kërkesat për përdorimin e gjerë industrial. Megjithatë, ende funksionojnë disa punishte të vogla tradicionale dhe një fabrikë më e madhe, e cila ndodhet në periferi të qytetit. Shkriticatja është ndërmarrja më e madhe industriale në këtë zonë, që ka punësuar mbi 2,000 punëtorë.

PËRDORIMI I TOKËS

Sipas përdorimit të tokës, qyteti mund të ndahet në katër zona:

- Zona industriale ndodhet në pjesën lindore të qytetit “PLVM” dhe përbëhet kryesisht nga fabrika dhe magazina, me burime industriale ndotëse duke përfshirë edhe fonderitë e shkrirjes së mineraleve me ngjyra.
- Pjesa e vjetër e qytetit dhe zona e qendrës së tij (10,000 banorë) zënë pjesën kryesore të tij. Pjesa e vjetër e qytetit duhet ruajtur për shkak të vlerave historike të tij. Funksionet bazë të kësaj pjese janë strehimi dhe shërbimet. Trafiku i kësaj zonë është i kufizuar në transportin e qytetarëve dhe shërbimeve.
- Zona intensive e banimit (30,000 banorë) ndodhet në pjesën veriore të qytetit. Kjo është zonë tipike banimi me blloqe të mëdha apartamentesh të ndërtuara në vitet 60 dhe 70-të. Në të ndodhen edhe hapësira për qendra të mëdha tregtimi dhe shërbimesh.
- Zonat periferike (10,000 banorë) shtrihen në pjesët jugore dhe perëndimore të qytetit. Ato përbëhen nga shtëpi të veçuara banimi.

GJENDJA E MJEDISIT (PERMBLEDHJE)

Në vitet 90të u akordua një sasi e madhe fondesh për mbrojtjen e mjedisit. Financimi pati ndikim pozitiv në mjedisin e qytetit “PLVM”. Përmirësimet më të mëdha u arritën në cilësinë e ajrit (ndotja e kishte origjinën nga burimet industriale). Gjithashtu u përmirësuan edhe tendencat negative nga ujrat e zeza dhe prodhimi i mbetjeve të ngurta.

Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në mjedisin rrethues

- Përqëndrimi i dioksidit të squfurit (SO_2) ndryshon sipas stinëve. Në dimër përqëndrimi rritet deri në 50-75 mg për metër kub (mg/m^3) dhe ai i grimcave në suspension deri në 20-30 mg/m^3 . Kjo tregon se ndotjet e kanë origjinën kryesisht nga burimet e ngrohjes.
- Përqëndrimi i oksidit të azotit (NO_x) dhe pluhurit që bie në sipërfaqe nuk kanë të bëjnë me ndryshimet e stinëve, që nënkupton se shkaktohen prej burimeve ndotëse të lëvizshme dhe fonderive.
- Në vitet e fundit nuk është bërë monitorim sistematik i cilësisë së ajrit në mjedisin rrethues. Gjatë një inspektimi të posaçëm, të ndërmarrë nga Qendra Rajonale Mjedisit, u zbulua një përqëndrim i madh i disulfurit të karbonit (CS_2) në një zonë afër fonderive dhe i benzenit në të gjithë qytetin, por sidomos përgjatë rrugëve.

Ndotja e ajrit nga burimet industriale

■ Shkrirja e metaleve me ngjyra

Ky biznes u ngrit në fillim të viteve 50të dhe u modernizua në vitet 90të. Fonderia prodhon rreth 35,000 ton metal në vit, pjesa më e madhe e të cilit përdoret për industrinë e ndërtimit. Situata financiare, në të cilën ndodhet kjo ndërmarrje është e keqe. Shqetësimi mjedisor që sjell fonderia shkaktohet më tepër nga shkarkimi në atmosferë i CS_2 dhe i pluhurave që përmbajnë grimca metalesh të rëndë. Rreth 10% e popullsisë së qytetit “PLVM” ka vuajtur pasojat e ndotjeve që transportohen nëpërmjet erës.

FIGURA 8 vazhdim

Rast Studimor — “Qyteti PLVM” vazhdim

■ Termocentrali

Termocentrali prodhon energji elektrike për rrjetin kombëtar të shpërndarjes si dhe shërben për ngrohje në fonderitë dhe ndërtesat e banimit që gjenden në Zonën III. Ai plotëson në masën 10 % edhe nevojat për furnizim me energji të shtëpive me nga një familje të vetme. Termocentrali është një objekt modern i ndërtuar në mes të viteve 80të. Në të gjenden dy blloqe fuqie (secili nga 10 MW fuqi) dhe një kaldajë uji. Gjithashtu, ekziston mundësia e përdorimit të nxehtësisë së shkuar dëm në turbinat ngrohëse duke rritur kështu prodhimin e nxehtësisë me 40 %.

■ Aktivitetet e tjera industriale

Aktivitetet e tjera industriale janë të vogla dhe nuk luajnë ndonjë rol të madh në shkarkimet e gazeve në atmosferë. Praktikisht nuk janë vërejtur raste problemesh të mëdha apo kronike lidhur me tejkalimin e niveleve të lejueshme të ndotjes.

Shkarkimet e gazeve nga transporti

Rritja e menjëhershme e numrit të makinave ushtron presion të ndjeshëm mbi qytetarët dhe mjedisin. Numri i makinave të regjistruara në pesë vitet e fundit është dyfishuar. Për momentin, numri i mjeteve të regjistruara (përfshi edhe automjetet e rënda) shkon në 9000. Përveç kësaj, qyteti nuk ka nënkalime për qarkullimin e trafikut ndërkombëtar, i cili kalon përmes Zonave I, III dhe IV, si dhe përgjatë kufirit të Zonës II. Mjetet e transportit publik urban janë të vjetra dhe me ndikim në mjedis. Nivelet e ndotjes dhe zhurmave në ajër, që krijohen si rezultat i këtyre mjeteve, kapërcejnë ndjeshëm nivelet e normave të lejueshme sidomos përgjatë pjesës së tranzitit ndërkombëtar dhe rrugëve që të çojnë në Zonën I. Intensiteti i trafikut në rrugët ndërkombëtare arrin në 25,000-30,000 automjete në ditë, 48% e të cilave janë mjete të rënda transporti. Ndërsa gjatë ditës intensiteti i trafikut arrin 600-1,200 mjete në orë.

Shkarkimet e gazeve nga shtëpitë e banimit

Për momentin, 85% e qytetarëve që banojnë në apartamente dhe 45% e atyre që jetojnë në shtëpi të ulëta përdorin gazin natyror dhe ujin e ngrohtë për ngrohje. Për më tepër, gazin natyror e përdorin si burim ngrohjeje edhe të gjitha objektet publike të banimit dhe shumica e objekteve të tjera publike. Por edhe "shkarkimet e vogla" që dalin nga djegia e

qymyrit nëpër shtëpi apo kaldaja përbëjnë problem serioz për mjedisin. Ndotësit më të mëdhenj që shkarkohen nga këto burime janë pluhuri, dioksidi i squfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe hidrokarburet aromatike ku përfshihet benzopireni (komponim shumë kancerogjen). Këto produkte çlirohen nga oksidimi në temperatura të ulëta dhe në sasi të kufizuara oksigjeni. Situata përkeqësohet sepse banorët djegin në kaldajat e shtëpive mbeturina të ndryshme ambalazhi (p.sh objekte plastike, etj). Në zonat ku shumica e shtëpive dhe objekteve të banimit përdorin qymyri si burim për ngrohje (p.sh pjesa e vjetër dhe qendra e qytetit, etj) ndotja e ajrit ka natyrë të rrezikshme (p.sh nga ndotësit e tipit të hidrokarbureve). Një tjetër zonë që ndodhet veçanërisht e ekspozuar ndaj shkarkimit të ndotjeve është ajo me shtëpi të ulëta në pjesën juglindore të qytetit. Llogaritjet tregojnë se 20% e popullsisë së qytetit gjendet e ekspozuar në mënyrë kronike ndaj ndotjeve. Ndërsa pjesa tjetër prej 60 % e popullsisë gjendet e ekspozuar ndaj ndotjeve në mënyrë periodike.


Cilësia e ujrave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë

Burimet dhe cilësia e ujrave sipërfaqësorë

Qyteti “PLVM” ndodhet në pellgun ujëmbledhës të lumit “PLVMi”, i cili është dhe lumi kryesor i rajonit. Lumi kalon përgjatë gjithë territorit të qytetit dhe përshkon zonën në fjalë nga perëndimi në lindje. Prurjet mesatare të lumit janë 15 m³ për sekondë (m³/s). Në tremujorin e parë të vitit 2000, inspektoriati mjedisor analizoi cilësinë e ujit të lumit nga ku rezultoi se uji nuk përmbushte as standartet e kategorisë së tretë. Në të dhënat e gjetura, parametrat më të dobët ishin BOD5 (kërkesa për oksigjenin biologjik gjatë një periudhe 5 ditore), bakteret koliforme, lëndët pezulli dhe klorofili “a”. Uji i lumit është në gjendje të ndotur para se të futet në qytet. Ai ndotet akoma më shumë pasi e përshkon atë.

Burimet dhe cilësia e ujrave nëntokësorë

Zona përreth qytetit ka burime të pasura dhe me cilësi të lartë të ujrave nëntokësore. Qyteti ka dy tubacione furnizues të ujit të pijshëm: tubacioni pas lumit, i cili furnizon me ujë 70 % të popullsisë dhe tubacioni tjetër në pyll, i cili furnizon 30 % e mbetur të popullsisë. Duke supozuar se ritmet e zhvillimit do të



- | | | | |
|---|-------------------------------------|---|------------------------------|
|  | Zonë industriale |  | Zonë periferike |
|  | Pjesa e vjetër dhe qendra e qytetit |  | Rrugë kombëtare dhe qytetëse |
|  | Zonë e dendur banimi |  | Hekurudhë |

FIGURA 8 vazhdim

Rast Studimor — “Qyteti PLVM” vazhdim

ecin me të njëjtën shpejtësi, atëherë kapacitetit të tubacioneve së bashku, mjafton për furnizimin me ujë të popullsisë edhe në 20 vitet e ardhshme. Ndonëse cilësia e ujit në tubacionin e pas lumit është e lartë, rregullat higjieno-sanitare kërkojnë trajtimin e ujrave.

Disa banorë përdorin puse për të marrë ujin nga toka, por cilësia e tij nuk është e kënaqshme. Matjet tregojnë nivele të larta nitrati me origjinë nga ujrat teknologjikë.

Shumica e bizneseve kanë sistemet e tyre të furnizimit me ujë.

Burimet kryesore të ndotjes së ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë

■ Menaxhimi i ujrave teknologjikë

Menaxhimi i ujrave teknologjikë mbetet problem për qytetin. Ndonëse para dy vjetësh është vënë në punë një impiant për pastrimin e këtyre ujrave, cilësia e ujit të lumit nuk është përmirësuar. Bakteret koliforme dhe lëndët organike, karakteristikë e shkarkimeve të ujrave të zeza, janë shkaku kryesor për nivelin e ulët të cilësisë së këtyre ujrave. Analizat e ujrave teknologjike, të bëra një vit pas vënies së impiantit në punë, tregojnë se sasia e ujrave teknologjike që shkarkohen në impiant e tejkalon me rreth 30 %, sasinë e ujrave që përdorin banorët dhe industria. Disa zona të qytetit nuk janë të lidhura me sistemin e grumbullimit të ujrave të zeza. Pjesa e vjetër dhe qendra e qytetit, si dhe blloqet e banimit janë të lidhura plotësisht me sistemin e grumbullimit dhe të trajtimit të ujrave të zeza. Ndërkohë, llogaritjet që vetëm 60 % e shtëpive të Zonës IV janë të lidhura me sistemin mbledhës të ujrave të zeza. Pjesa tjetër kanë depozita individuale për pastrimin e ujrave, të cilat shpesh kullojnë. Në qytet vërehen edhe ndërhyrje ilegale në kolektorët të ujrave të shiut nga individë, biznese të vogla apo punishte.

Kolektori kryesor i ujrave të shiut që shkarkon ujrat direkt në lumë përbën një burim tjetër ndotjeje. Daljet e tij nuk kanë pajisje për veçimin e rërës dhe ndotjeve vajore. Ky kolektor mbulon pjesën e vjetër të qytetit, qendrën e tij dhe disa shtëpi (që zenë 60% të zonës).

Fonderia është një burim tjetër ndotjeje, pasi shkarkon ujrat, që përdoren për ftohje direkt në lumë. Kur rrjedha e lumit është e ngadaltë, kjo masë uji kontribuon në rritjen e konsiderueshme të temperaturës dhe në eutrofizimin më intensiv të tij.

MENAXHIMI I MBETJEVE

Mbeturinat urbane

Kapaciteti i planifikuar i fushës për depozitimin e mbetjeve të qytetit është 230 000 m³, për një afat kohor prej 15 vjetësh. Sipas llogaritjeve, më 1 Janar 2002, fusha për depozitimin e mbetjeve është mbushur deri në 30% të kapacitetit të saj mbajtës. Çdo vit transportohen për në fushën e depozitimit të mbetjeve rreth 60,000 m³ mbeturina nga qyteti “PLVM” dhe zonat përreth. Hapësira ku depozitohen mbetjet përbush të gjitha kërkesat ligjore përsa i takon parandalimit të ndotjeve në tokë dhe në ujrat nëntokësorë si dhe menaxhimit të përshtatshëm. Rezultatet e monitorimit nuk tregojnë se kjo fushë e depozitimit të mbeturinave ndikon në cilësinë e ujrave nëntokësorë.

Mbledhja e mbeturinave me sistemin pa ndarje paraprake të tyre mbulon rreth 90 % të popullatës.


Mbeturinat industriale dhe të rrezikshme

Mbeturinat industriale dhe të rrezikshme që prodhon qyteti depozitohen nga fushën e depozitimit të mbeturinave industriale, e cila ndodhet brenda territorit të fonderisë. Pjesa më e madhe e mbeturinave vjen nga fonderia. Këto mbetje përmbajnë lëndë me përbërje arseniku, zinku, kadmiumi dhe sasi të vogla pumbi.

Prodhuesi i dytë më i madh i mbeturinave industriale është termocentrali. Ai shkarkon hirin e mbetur nga djegia dhe mbetjet nga elektrofiltri, në fushën e vet të depozitimit të mbeturinave.

Mbeturinat spitalore transportohen në furrën e djegies së mbeturinave spitalore. Kjo furrë nuk i përmbush kërkesat për trajtimin me metoda moderne të mbeturinave spitalore. Gjithsesi, qyteti nuk ka ndonjë mundësi tjetër për të përdorur për këtë qëllim. Në të digjen edhe mbeturinat kirurgjikale dhe veterinare. Sipas inspektimeve të bëra kohët e fundit, është gjetur se në shumicën e këtyre vendeve kryhet zbatimi korrekt i rregullores.

Problemet e mbeturinave të rrezikshme që prodhohen nga shtëpitë, bizneset e vogla dhe shllami i krijuar nga trajtimi i ujrave të zeza, vazhdojnë të mbeten ende të pazgjadhura.



Mjete Trainimi

Mjeti 1: Analiza SWOT

Përshkrimi : Analiza SWOT dhe parapërgatitja e grupit

Pjesëmarrësit: Grupe të vogla

Kohëzgjatja: 45 minuta

Procedura:

- 1** Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla, ku secili grup të punojë në njërin prej rasteve studimore: kushtet lokale natyrale, potenciali njerëzor, infrastruktura teknike ose potenciali ekonomik.
- 2** Secilit grup i duhet të përgatisë në 30 minuta, analizën SWOT për fushën përkatëse.
- 3** Përgatiteni analizën sipas modelit SWOT në formën e tabelës së mëposhtme:

Anët e Forta	Anët e dobta
Mundësitë	Rreziqet

Diskutim:

Jepu kohë grupeve të paraqesin dhe diskutojnë mes tyre punën e bërë.



Mjeti 2: Problemet e rastit studimor

Përshkrimi: Trajnimi i pjesëmarrësve në përcaktimin dhe formulimin e problemit

Pjesëmarrësit: I gjithë grupi

Kohëzgjatja: 30 minuta

Procedura:

1 Çdo pjesëmarrësi i jepen 10 minuta kohë për të përcaktuar në mënyrë individuale një listë të problemeve që paraqiten në rastin studimor. Më pas çdonjëri përshkruan problemin dhe shpjegon arsyet që e bëjnë atë shqetësues për komunitetin.

Disa këshilla

- Vendos që në fillim se ç'duhet kuptuar me "probleme mjedisore". P.sh disa komunitete konsiderojnë krimet, njerëzit e pastrehë, zhgaravinat në pjesën e jashtme të banesave si probleme mjedisore, ndërsa të tjerët mendojnë ndryshe.
- Përqëndrohu në ato probleme, të cilat komuniteti mund t'i kontrollojë. P.sh mund të kontrolloni më lehtë ndotjen nga makinat, sesa ngrohjen globale.

2 Traineri ose një vullnetar nga grupi mund të shkruajë problemet e gjetura në tabelë. Pasi të përcaktohen problemet, i gruponi ato në fusha problemore (p.sh "ndotja e ujrave nëntokësorë nga rrjedhjet e zonës ku ndodhet fusha e depozitimit të mbeturinave ", "ndotja e mundshme nga mbetjet e rrezikshme të depozituara në fushën e depozitimit të mbeturinave të qytetit" dhe "depozitimet e paligjshme të mbeturinave në pyje", mund të grupohen së bashku nën një fushë problemore të titulluar: "ndotjet e mjedisit të shkaktuara nga mbetjet e ngurta").

Diskutim:

Si mund të vendosim se cilat prej problemeve mjedisore janë të përshtashme për t'u trajtuar nga një organizatë mjedisore ? A mbetën pjesëmarrësit të kënaqur nga vendimi i grupit ? A është e domosdoshme që një organizatë ta përjashtojë veten nga aktivitetet "e tjera", edhe pse e ka kapacitetin për të përmirësuar gjendjen?

2

Mjeti 3: Shkaku dhe pasoja

Përshkrimi: Listimi i shkaqeve dhe pasojave që çojnë në probleme mjedisore, kusht për përgatitjen planifikuese

Pjesëmarrësit: Grupe të vogla (njësoj si tek Mjeti 2)

Kohëzgjatja: 30-40 minuta

Procedura

- 1 Fushat problemore që janë përcaktuar në Mjetin 2 të seksionit paraardhës, mund të përdoren si bazë për këtë ushtrim. Pjesëmarrësit duhen ndarë në grupe të vogla, ku secili prej tyre punon për një apo më shumë se një fushë problemore të ushtrimit.
- 2 Puna në secilin grup duhet të fillojë nga përzgjedhja e problemit qendror të fushës problemore. Problemet/përcaktimet e tjera duhen shpërndarë sipas tendencës që kanë për të shkuar drejt problemit kryesor, apo për tu gjeneruar prej tij (shkaqet renditen në diagramën në formë peme, nën problemin bazë. Ndërsa pasojat renditen në nivelet sipër problemit).
- 3 Më pas, kaloni në hollësi. Për shkaqet pyesni: “Ç’farë e shkakton këtë?”. Për pasojat pyet: “Cili është pasoja e kësaj?”.

Diskutim:

Grupet të paraqesin përfundimet dhe t'i diskutojnë ato së bashku.

Disa këshilla:

- Shkruani shkaqet dhe pasojat në letra të vogla ngjitëse (një shkak për çdo letër), më pas ngjitini letrat në tabelë. Duke përdorur këto letra ju do ta keni më të lehtë të bëni zhvendosjen e një letre nga një pozicion në tjetrin nëse nuk e keni vendosur si duhet që në fillim.
- Shmang përfshirjen në pemë të problemeve shumë të përgjithshme (p.sh korrupsioni institucional, mungesa e fondeve), të cilat ndikojnë jo vetëm në problemin në fjalë, por edhe në probleme të tjera — është më mirë që këto t'i trajtoni si kufizime të përgjithshme dhe t'i vendosni anash problemeve kryesore të paraqitura në pemë.
- Në kuadër të këtij trajnimi mund të përzgjidhni një numër të kufizuar problemesh kryesore, nga numri i përgjithshëm në pemën e problemeve (p.sh nga një problem për secilin grup).

3

Mjeti 4: Shtjellimi i pemës

Përshkrimi: Përcaktimi nga pjesëmarrësit i qëllimeve dhe objektivave, duke e shndërruar pemën e problemit në pemë të objektivave.

Pjesëmarrësit: Grupe të vogla

Kohëzgjatja: 30 minuta

Procedura

- 1 Përbërja e grupeve që punuan me pemën e problemeve mund të mbetet e njëjtë edhe për detyrën e pemës së objektivave. Detyra e tyre është të shndërrojnë përcaktimet negative (problemet/shkaqet) në fjali pozitive. P.sh fjalia "Përpunim i pamjaftueshëm i ujrave të zeza" mund të kthehet në "Përpunim efektiv i ujrave të zeza".
- 2 Mbani parasysh se pema e objektivave nuk është e thënë të jetë pasqyrim i plotë i pemës së problemeve. Dy objektiva mund të adresojnë të njëjtin problem (p.sh problemi — "ndërgjegjësimit i dobët i publikut" mund të riformulohet në "ndërgjegjësimit i lartë mjedisor i publikut" dhe "sisteme të mira informimi për publikun").

Diskutim:

Kërkojuni grupeve të paraqesin punën e tyre në shndërrimin e fjalive. Cilat prej problemeve janë të vështira për t'u shndërruar në objektiva? A është një problem gjuhësor, apo jo i shprehur mirë? A ka ndonjë rrezik kur tregohesh tepër pozitiv?



Mjeti 5: Si dhe kush

Përshkrimi: Zhvillimi i strategjive efektive për zgjidhjen e problemeve

Pjesëmarrësit: Grupe të vogla

Kohëzgjatja: 30-40 minuta

Procedura :

- 1 Pasi të zotërohet përfytyrimi për situatën e dëshiruar të së ardhmes dhe qëllimet e objektivat e detajuar, është e nevojshme t'i jepet përgjigje dy pyetjeve kryesore: Si arrihet kjo? Kush mund ta bëjë?
- 2 Pjesëmarrësve u duhet të përgatisin një plan veprimi, sipas strukturës së propozuar në figurën 14. Organizimi i grupeve do të ketë të njëjtën përbërje si në ushtrimin pararendës.

Disa këshilla:

- Merr në konsideratë të gjitha kategoritë e aktiviteteve — mos u përqëndro vetëm tek zgjidhjet teknike.
- Nëse është e nevojshme, mund të punosh më tej me objektivat, për t'i bërë ato edhe më specifike.

FIGURA 9

Formati për planin e veprimit

Qëllimi strategjik	Objektivat specifike	Treguesit	Veprimet	Hapat	Përgjegjësit	Afati kohor	Shpenzimet	Burimet e financimit
1	1.1		1.1.1	A				
				B				
	1.2		1.2.1	A				
				B				
	1.2.2		A					
			B					
2	2.1		2.2.1	A				

Diskutim:

Grupet të paraqesin punën e tyre dhe të diskutojnë me grupet e tjerë

5

Mjeti 6: Analiza e kriterëve

Përshkrimi: Përshatja me metodën e analizës së kriterëve, e cila përdoret për përcaktimin e prioritetëve të plan-veprimit

Pjesëmarrësit: Fillimisht çdo pjesëmarrës, pastaj grupe të vogla

Kohëzgjatja: 20-30 minuta


Procedura:

- 1 Metoda krijon mundësinë e përcaktimit të prioritetëve për aktivitetet në mënyrë objektive. Në të njëjtën kohë, ajo pasqyron edhe mendimin e komunitetit për to. Analiza e kriterëve është një metodë efektive për arritjen e konsensusit, sidomos kur përbërja e grupit është heterogjene.
- 2 I gjithë grupi duhet të bëjë përcaktimin e tre deri në pesë kriterëve (për të bërë këtë mund të përdoret lista e kriterëve të paraqitur në materialin teorik). Për secilin nga kriteret e përcaktuara, jepni një nga tre nivelet e rëndësisë (p.sh i lartë, i mesëm, i ulët)
- 3 Më pas kërkoni që grupet të bëjnë vlerësimin e aktivitetëve sipas kriterëve të përcaktuara më parë.

Diskutim:

Kërkoni që grupet të paraqesin përfundimet e tyre dhe t'i diskutojnë ato me të tjerët.

6



Modeli i programit të takimit

Si duhet dhënë trajnimi

Ky model programi synon t'ju ndihmojë të krijoni një trajnim për hartimin e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM), nëpërmjet përdorimit të disa elementeve të këtij manuali dhe mjeteve të tij trajnues. Përdorimi i saktë i tij, kombinimi dhe me aktivitete të tjera, duhet bazuar në njohjen që keni mbi përvojën dhe pritjet e grupit që do të trajnohet dhe në kohën që është në dispozicion për realizimin e trajnimit. Përveç temave të trajnimit, programi ju propozon edhe aktivitete që e pasurojnë trajnimin me elementë gjallërues.

Modeli i programit të takimit: DITA 1

Seksioni hyrës

KATEGORIA

QËLLIMI

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Qëllimet dhe pamje e përgjithshme e trajnimit

Përshkruaj shkurt programin dhe pyet pjesëmarrësit për nivelin e pritshëm të njohurive që duan të marrin

Paraqitje

Paraqitja e pjesëmarrësve

Njohja me njëri-tjetrin

Dy grupe objektesh (stillapsa, lapsa, qirinj, dhurata nga rajoni i tyre). Pjesëmarrësit që kanë marrë të njëjtin objekt, bëhen pjesë e së njëjtës skuadër dhe i drejto në njëri-tjetrit pyetje personale dhe profesionale. Më pas bashkohen në grupin e madh dhe paraqesin njëri-tjetrin

Paraqitja e PLVMsë

Familjarizimi i pjesëmarrësve me fazat e PLVMsë

Paraqitja e procesit të PLVMsë(Figura 1)

Seksioni 1 — Organizimi i projektit

KATEGORIA

QËLLIMI

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Hyrje në organizimin e projektit

Shpjego rolin e njësisë koordinuese, grupit të interesuar dhe autoriteteve vendore

Paraqitje

Organizimi i projektit sipas rastit studimor

Diskutim për strukturën e projekteve të ndryshme të PLVMsë në komunitetet e pjesëmarrësve, lidhjen mes tyre dhe metodave të përfshirjes dhe nxitjes së publikut

Diskutim në grup

Modeli i programit të takimit: DITA 1 vazhdim		
Seksioni 2 — Krijimi i grupit të interesuar		
KATEGORIA	QËLLIMI	AKTIVITETET E PROPOZUARA
Grupi i interesuar (Hyrje)	Shpjegim në detaje mbi rolin dhe përbërjen e grupit të interesuar, anëtarësimi i anëtareve të rinj dhe organizimi i takimit të parë.	Paraqitje
Organizmi i projektit në komunitete lokale	Diskutim mbi përbërjen e grupit të interesuar në komunitetet e pjesëmarrësve, anëtarësimin e pjesëmarrësve të rinj, programin e takimit të parë, etj.	Diskutim në grup
Seksioni 3 — Vlerësimi paraprak i potencialit dhe kufizimeve të komunitetit		
KATEGORIA	QËLLIMI	AKTIVITETET E PROPOZUARA
Hyrje në analizën SWOT	Shpjegim rreth metodës SWOT dhe përdorimin e saj në vlerësimin paraprak të potencialit dhe kufizimeve të komunitetit	Paraqitje
Analiza SWOT për rastin studimor të komunitetit	Vendosni një platformë për komunikimin e grupit dhe trajnimin mbi analizën SWOT	Mjeti 1: Analiza SWOT
Seksioni 4 — Raporti i gjendjes mjedisore		
KATEGORIA	QËLLIMI	AKTIVITETET E PROPOZUARA
Raporti i gjendjes mjedisore	Përshkruani komponentët kryesorë të raportit mbi gjendjen e mjedisit	Paraqitje
Zhvillimi i një raporti mjedisor për një rast studimor nga komuniteti	Shpjegim mbi elementët specifikë Diskutim rreth raportit dhe metodat praktike për hartimin dhe plotësimin e tij	Diskutim në grup
Seksioni 5 — Përcaktimi i problemeve		
KATEGORIA	QËLLIMI	AKTIVITETET E PROPOZUARA
Hyrje në metodologjinë e përcaktimit të problemit	Shpjegim rreth bazës përcaktuese të problemit (raporti i gjendjes mjedisore, çështjet që duhen pasur në konsideratë, problemet e sotme dhe të ardhme	Paraqitje
Përcaktimi i problemeve në rastin studimor	Trajnim mbi metodën e përcaktimit të problemeve (grumbullo ide dhe arrij në konsensus)	Mjeti 2: Problemet e rastit studimor

Modeli i programit të takimit: DITA 1 vazhdim

Seksioni 6 — Vlerësimi i Problemit

KATEGORIA

Hyrje në analizën në trajtë peme të problemit

Vlerësimi i problemeve të rastit studimor

QËLLIMI

Shpjegim rreth analizës në trajtë peme të problemit dhe përdorimit të saj për vlerësimin e problemeve

Trajnim mbi analizën në trajtë peme të problemit

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Mjeti 3: Shkaku dhe pasoja

Modeli i programit të takimit: DITA 2

Seksioni 7 — Përcaktimi i qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike

KATEGORIA

Hyrje në analizën në trajtë peme të problemeve

Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave në rastin studimor

QËLLIMI

Shpjegim rreth pemës së objektivave dhe përdorimit të saj për të përcaktuar qëllimet dhe objektivat

Trajnim mbi përcaktimin e qëllimit dhe objektivat nëpërmjet shndërrimit të pemës së problemeve në pemë objektivash

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Mjeti 4: Shtjellimi i pemës

Seksioni 8 — Përcaktimi i veprimeve

KATEGORIA

Përcaktimi i veprimeve

Zhvillimi i strategjive (planeve të veprimit) për zgjidhjen e problemeve të rastit studimor

QËLLIMI

Familjarizimi i pjesëmarrësve me llojet e veprimeve/ndërhyrjeve dhe mënyrat për përshkrimin e tyre

Trajnim për pjesëmarrësit në përcaktimin dhe shpjegimin e planeve të veprimit

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Mjeti 5: Si dhe kush?

Modeli i programit të takimit: DITA 2 vazhdim

Seksioni 9 — Përcaktimi i prioriteteve për veprim

KATEGORIA

Përcaktimi i prioriteteve për veprim

Përcaktimi i prioriteteve të rastit studimor

QËLLIMI

Përshtatje e pjesëmarrësve me analizën e kritereve prioritare të veprimit

Trajnim për pjesëmarrësit mbi mënyrën e përdorimit të analizës së kritereve

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Mjeti 6: Analiza e kritereve

DITA 3

Seksioni 10 — Shkrimi i dokumentit PLVMsë

KATEGORIA

Shkrimi i dokumentit të PLVMsë

Shkrimi i PLVMsë për rastin studimor nga komuniteti

QËLLIMI

Paraqitje për pjesëmarrësit e elementëve të një PLVMje të suksesshme.

Diskutim i qëllimeve dhe përmbajtjes së dokumentit, si dhe aspektet praktike të përgatitjes paraprake të tij

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Diskutim në grup

Seksioni 11 — Zbatimi dhe monitorimi

KATEGORIA

Hyrje mbi zbatimin dhe monitorimin e PLVMsë

Hapat e tjerë

QËLLIMI

Paraqitje e bazave të zbatimit dhe monitorimit të PLVMsë

Diskutim për hapat e tjera

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Paraqitje

Diskutim në grup

Seksioni 12 — Përmbledhje e trajnimit (diskutim i përgjithshëm)

KATEGORIA

Përmbledhje e trajnimit

QËLLIMI

Lehtësuesit bëjnë përmbledhjen e trajnimit dhe diskutimeve në grupe për tema të veçanta të PLVMsë

AKTIVITETET E PROPOZUARA

Diskutim në grup

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT PËR EVROPËN QENDRORE DHE LINDORE

(REC) është një organizatë jo-partizane, jo-advokuese, jo-fitimprurëse që ka mision të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Qendra përmbush misionin e saj përmes nxitjes së bashkëpunimit mes organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe subjekteve të tjera të fushës së mjedisit, përmes mbështetjes të shkëmbimit të lirë të informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjen për mjedisin.

REC është themeluar më 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot, REC mbështetet në Dokumentin themeltar të nënshkruar nga qeveritë e 27 vendeve dhe Komisioni Evropian, si dhe në një Marrëveshje Ndërkombëtare me Qeverinë e Hungarisë. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyra lokale në secilin nga 15 vendet përfituese të EQL: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maqedoni, Poloni, Rumani, Sllovaki, Slloveni, dhe Jugosllavi. Donatorët e sotëm janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Shqipërisë, Belgjikës, Bosnjë Hercegovinës, Bullgarisë, Kanadasë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Letonisë, Lituanisë, Hollandës, Polonisë, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar, SHBASë dhe Sërbia dhe Mali i Zi, si dhe organizata të tjera ndër-qeveritare dhe institucione private.



Planet lokale te veprimt ne mjedis